

LUTJE SHPIRTIT
SHENJT

Renovabis



HAPË ZEMRËN
TIME



Foto: Michael Kunz

Të dashur besimtarë!

Është Shpirti Shenjt ai i cili siellte gjitha të mirat në ne (Shih Rom: 8,25). Pranishmëria e Tij në kohën tonë është më e rëndësishme se kurrë më parë. Dhuratat e Tija sjellin ripërtir-

je, dije, forcë, besimi dhe shërim. Përveç kësaj Ai na ndihëmon të dallojmë, çfarë na bënë mirë dhe çfarë na bënë dëm. Shpirti Shenjt është edhe Dashuria e cila na drejton dhe na shtyen tek Zoti dhe tek njerëzit, për të ecur drejt tyre.

Ky doracak lutjesh do të jetë një shoqëruese për ecjen tonë personale me Shpirtin e Zotit. Formati i saj i dobishëm i shërben këtij qëllimi. Mund ta marrim kudo. Në të njëjtën kohë, duhet të shërbejë edhe për lutje të përbashkëta. Shpirti Shenjt lidh njerëzit me njëri-tjetrin. Me këtë doracak që është në gjuhë të ndryshme, dëshirojmë të ndërtojmë një urë të lutjes mes njërezëve ne vendet partnere, ne Evropën e mesme-lindore dhe qendrore-lindore. Aty ku është Shpirti i Zotit, aty ka bashkim dhe mirëkuptim.

Thomas Schwartz

Prof. Dr. Thomas Schwartz
Udheheqës i pergjithëshëm i Renovabis



FRYMO NË MUA!

Frymo në mua, o Shpirt Shenjt!
Që te mendoj shenjtërisht!
Më bëj mua, o Shpirt Shenjt!
Që të veproj shenjtërisht.
Më josh mua, o Shpirt Shenjt!
Që të dua shenjtërisht.
Më forco mua, o Shpirt Shenjt!
Që të mbroj të shenjtën.
Më mbro mua, o Shpirti Shenjt!
Që kurrë mos të humbas Ty.

Nga Shën Augustini

TI ZJARR I SHENJT

Ti zjarr i shenjt,
ndizi flakë zemrat tona.
Ti ujë i shenjt,
rrjedh në marrëdhëniet tona.
Ti Shpirti Shenjt,
jepu flatra medimeve tona.
Ti ndërmjetësues i shenjt,
foli brendësisë sonë.
Ti pëllumb i shenjt,
fluturo në botën tonë.
Ti dashuri e shenjtë,
frymëzo të gjithë njerëzit.

Anton Rotzetter

LUTJE SHPIRTIT SHENJT

Eja o Shpirti Shenjt, Ti shpirt i së vërtetës,
që na bënë të lirë.

Ti Shpirt i stuhisë, që s na lenë të qetë.

Ti Shpirt i guximit, që ne na forcon.

Ti Shpirt i zjarrit, që na bën besimtarë

Eja o Shpirti Shenjt,

Ti Shpirt i dashurisë, që neve na bashkon.

Ti Shpirt i gëzimit, që na lumturon.

Ti Shpirt i paqes, që na bënë të falim.

Ti Shpirt i shpresës, që na bënë të mirë

Eja o Shpirti Shenjt!


Leonardo Boff



LUTJE SHPIRTIT SHENJT

O Shpirt Shenjt,
 Ti dashuri e Atit dhe e Birit,
 më mëso çfarë të mendoj.
 Më thuaj, çka duhet të flas,
 dhe si duhet të flas.
 Më thuaj, si mund të hesht,
 dhe të bëhëm i sjellshëm.
 Më thuaj, çfarë duhet të bëj
 për nder të Zotit,
 për të mirën e shpitrave
 dhe për shenjtërimin tim.

Shpirti Shenjt,
 Më jep mendjen e kuptimit
 dhe të njohjes
 Më jep aftësinë
 që t'u përmbahëm
 të gjithave.



Mi mëso mënyrat dhe
 më jep aftësi, që t'i mësoj vazhdimisht.
 Më jep mendjemprehtësinë,
 për të interpretuar drejt
 dhe për të dalluar;
 Më jep Hirin, që të flas dobishëm.

Shpirti Shenjt,
 Më jep vetëbesim për fillim të mbarë.
 Më udhëzo dhe më udhëheq në veprime,
 që t'i përfundoj në mënyrë të përsosur.
AMEN

Lutja e perditshme e Gjon Palit II

SHPIRT I JETËS

Shpirt i jetës, më hap zemrën ndaj dhuntive Tua!

Shpirt i së vërtetës, më lejo mua që në turbullirat
e mendjes të njoh të vërtetën e Hyjit.

Shpirt i dashurisë, më shëndërro mua,
që të mund ta dua të vërtetën!

Shpirt i paqës, më ndihmo,
të sjell paqe dhe pajtim!

Shpirt i gëzimit, më bejë mirënjohës,
për të gjitha të mirat në jetën time!



SHPIRT SHENJT

Shpirt Shenjt, më jep besimin,
të më mbrojë nga dyshimet dhe veset.
Më jep dashuri ndaj Zotit dhe njerëzve,
të zhdukë çdo urrejtje dhe hidhërim.
Më jep shpresën,
që më çliron nga frika dhe dëshprimi.

Dietrich Bonhoeffer

SHPIRT SHENJT

Shpirt Shenjt,
Ti Shpirt i së vërtetës, më ndriço mua,
që të mund të zhvilloj ndjenjën,
për gjërat thelbësore në jetën time.

Ti Shpirt i forcës, bejë që
të qëndroj me këmbë në tokë

Ti Shpirt i lirisë, më liro,
që unë të mësohem
të shërbej, në paqe dhe drejtësi.

Ti Shpirt i këshillit, më nxit mua
që në avanturën time të shoqërohem
më guximin e Zotit.

Ti Shpirt i dijes, drejtoje mendjen time,
që me afsh t'i nderoj,
krijimin dhe krijesat.

Ti Shpirt i lutjes, lutu në mua,
që Zoti përmes meje të flet

Ti Shpirt i dashurisë së Zotit,
më mbro mua,
që të jetoj përgjithmonë
me shpresë dhe nga shpresa

I ripërrirë me entuziazëm,
dua të filloj përkrahjen
për ardhjen e botës sate të re.

Luis Gurndin

EJA SHPIRTI SHENJT! NE KEMI NEVOJË PËR TY

Eja Shpirti Shenjt! Ne kemi nevojë për Ty.
Ne jemi të pasigurt, deri sa të tjerët
presin fjalën tonë.
Fol përmes nesh, që t'ua tregojmë atyre rrugën.

Eja Shpirti Shenjt! Ne kemi nevojë për Ty.
Ne jemi të lodhur, udhëtojmë ngadalë atje
ku më endje gjejmë qetësinë.
Jepna forcë, t'i orientojmë të tjerët,
dhe bënë që kjo të jetë e dobieshme për ta.

Eja Shpirti Shenjt! Ne kemi nevojë për Ty.
ne ndihemi të rëndësishëm,
por nëse Ti neve na prek, atëherë ne
përrjetojmë se Ati ynë qiellor na thotë:..
„Ti je për mua i rëndësishëm.“

Eja Shpirti Shenjt! Ne kemi nevojë për Ty.
Ne jemi më nxitim, sepse kemi ende
shumë për të bërë.
Mirëpo kur jemi në afërsinë tënde
për një moment të shkurtër,
Dashuria e Zotit na frymëzon
dhe nxjerr prej nesh të ligat e shpirtit.

Eja Shpirti Shenjt! Ne kemi nevojë për Ty.
Kur Ti ne na prekë, ne shohim në tjetrin
shkëlqimin që vjen prej Hyjtit.

Tilman Beller



SHPIRTI I ZOTIT

Shpirti i Zotit, Shpirti Shenjt,
 Nëpër të cilin marrë frymë, nga i cili marrë frymë,
 dhe përmes të cilit marrë frymë.
 Më lëviz, më zgjo,
 më përgatit të jem i gatshëm për të varfër.
 Më motivo për një shërbim në dialog,
 më forco të dëshmoj të vërtetën.

Fuqia e Shpirtit të Zotit, dërguar prej Atit,
 dhe e premtuar prej Birit,
 më ruaj nga krenia dhe arroganca.
 Më shoqëro çdo ditë në takime,
 më dhuro dhunti dhe karizmë
 që unë njerëzve të mund t'ua zbuloj.
 Më mbro nga padrejtësitë dhe armiqësitë
 e pashmangshme,
 më ruaj nga çdo përplasje.

Shpirti Shenjt, Ti rojtës i Kishës sate,
 mbroje dhe përcjelle atë gjatë rrugëtimit të saj.
 Mos lejo askënd që gjatë këtij
 rrugëtimit të humbas,
 mos lejo as ne të ndahemi prej Kishës.

Ngushëllues Hyjnor – Hyj Paraklet
 Ne nuk dimë, si do të duket e ardhmja jonë.
 Ne nuk dimë, para cilave sfida do të ndodhemi.
 Ne nuk dimë, nëse do të tregohemi
 të fortë apo të dobët.
 Por Ti na ngushëllo me premtimin e pranisë tënde.

Ti na forco me dhuntitë e tua.
 Ti na del zot me fuqinë e dashurisë sate.
 Ji me ne në ndërtimin e Mbretërisë Hyjnore,
 në të cilën, nëper Ty, Shpirti Shenjt,
 ne lavdërojmë Atin dhe Birin
 në të gjitha ditët e jetës, në shekuj të shekujve.
 Amen

Thomas Schwartz

